



Breaking News:

DVP Durrës, gjatë 24 orëve të fundit

⏏ ⏪ ⏩



Lajmet

Operacionet

22/01/2025

Mat – Finalizohet „Operacioni Policor I Koduar “Burgajeti”

Mat/Kontrolle intensive, bazuar në inteligjencën policore, për parandalimin dhe goditjen e armëmbajtjes pa leje. Finalizohet nga Komisariati i Policisë Mat, operacioni policor i koduar “Burgajeti”.

Sekuestrohen një armë zjarri kallashnikov dhe qindra fishekë luftarak.

Vihet në pranga poseduesi i tyre.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative, se një shtetas mbante armë zjarri, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Burgajeti”.

Si rezultat i operacionit, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Rr. M., 59 vjeç, banues në fshatin Burgajet, pasi shërbimet e Policisë gjetën të fshehura në banesën e tij, një armë zjarri kallashnikov dhe 813 fishekë luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

https://youtu.be/sbKdjWctaHU

◄ Kamëz – Me armë zjarri pistoletë, në rrugë, në cenim të autorizimit, arrestohet 44-vjeçari

Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Distanca” ►

Kërko

Enter a word for search

🔍

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)